



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rr“Abdi Toptani”, nr.1, Tiranë;E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 27/12/2018

V E N D I M

Nr.232, Datë 20/12/2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËNDOGANORETIRANË “MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE” për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

Konstatohet se, gjatë vitit 2017 nga Dega Doganore Tiranë është punuar përgjithësisht mirë për zbatimin e përgjegjësiwe funksionale në drejtim të mbledhjes së të ardhurave doganore, të cilat janë realizuar në masën 104 % kundrejt planit, pra me një tejkalim në të ardhurat e buxhetit të shtetit në shumën 2,359 milion lekë, por u konstatuan të meta e mangësi në drejtim të zbatimit të legjislacionit doganor, procedurave të zhdoganimit, administrimit të akcizës, mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike, nxjerrjes së vendimeve administrative, si dhe administrimit dhe rikuperimit të borxhit doganor, të cilat kanë sjellë për pasojë efekte negative për buxhetin e shtetit **në shumën 996,042 mijë lekë.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit,shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit,Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”,të ushtruar në Degën Doganore Tiranë, sipas Programit të Auditimit nr. 660/1prot, datë 13.06.2018, ndryshuar me shkresat nr. 660/2 prot, datë 24.07.2018 dhe nr. 660/3prot, datë 23.08.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor, që lidhen me vlerësimin doganor artikujve që janë deklaruar në kapitullin *02*, ku janë evidentuar mospërputhshmëri ligjore me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...*”, keqinterpretim i shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 1945prot., datë 25.01.2016 “*Mbi zhdoganimin e artikujve që deklarohen në kapitullin *02* me origjinë EU*”, shpjegimeve dhe përcaktimeve të neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr. 14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi:Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shfuqizojë shkresat nr. 1945 prot, datë 25.01.2016 dhe nr. 2344 prot, datë 28.01.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “*Mbi zhdoganimin e artikujve që deklarohen në kapitullin 02*”, lidhur me interpretimin e vlerësimit doganor të artikujve deklaruar në kapitullin I të Nomenklaturës së Mallrave në RSH sipas përkrahimit “*Mishi dhe të brendshmet e tij*”, të cilat bien ndesh me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit*”. Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit do të trajtohet në vijimësi me të njëjtin qëndrim kjo problematikë deri në momentin që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Publik më i lartë juridiksionaldo të shprehen zyrtarisht për vlefshmërinë apo shfuqizimin e shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016, të cilat bien ndesh me përcaktimet dhe trajtimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”.

1.2 Rekomandimi:Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë në vijim të procedurave të mëtejshme, të vlerësojë dhe gjykojë për problematikën e cituar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, duke ndjekur dhe respektuar metodat dhe rradhën e procesit ligjor të vlerësimit doganor dhe përputhshmërinë me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të Ministrisë të Financave “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”, Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*” dhe përcaktimeve të neneve 34 deri 36 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar dhe neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë për problematikën e cituar sa më lart të kryejë dhe ezaurojë të drejtën e procedurave doganore verifikuese pranë selive të kompanive lëvruese të mallit për artikuj të deklaruar në kapitullin II të Nomenklaturës së Mallrave në RSH dhe pranë Autoriteteve Doganore Homologe respective, bazuar në Marrëveshjet Reciproke të Asistencës Administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Vendeve ku janë të atashuara selitë lëvruese të këtij artikulli, me të cilët administrata doganore shqiptare ka

Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore, për deklaramë doganore të periudhës nën juridiksion auditimi nga Administrata Doganore Shqiptare, duke garantuar njëkohësisht edhe borxhin doganor që mund të lindë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen veprime deklaruese që kanë rezultuar me ulje të vlerës statistikore të vlerave të faturuara për mallra të natyrës kryesisht makina/autovetura dhe medikamente, në shumën 199,798,824 lekë, për vlera të tatueshme të mallrave të importuara, ku është përfshirë TVSH-ja, duke u bazuar në ligjin nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ku ka rezultuar ulje të çmimit për rastet e zbritjes për pagesa të kryera për furnizimin, si dhe reduktimet e çmimit që i bëhen blerësit për mallrat të cilat përjashtohen nga detyrimet doganore. Gjithashtu, për mallra të natyrës autovetura rezultuan mosllogaritje të vlerës së shpenzimeve të transportit në disa raste, me efekt financiar në shumën 4,396,563 lekë për deklarues të natyrës individë. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë, nëpërmjet personelit përpunues doganor dhe Sektorit të Kontrollit pas Zhdoganimit, të ndërtojë programe kontrolli specifike verifikuese, si dhe të gjejë për ndihmën dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Kontrollit pas Zhdoganimit në DPD, që në bazë të nenit 102 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, për periudhën 01.01.2016-31.06.2017, dhe neneve 47,48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për periudhën 01.07.2017-31.12.2017, për praktikën doganore të evidentuara në shumën 199,798,824 lekë, sipas rasteve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe që do të deklarohen në vijim me efekte të reduktimit të vlerës së TVSH-së dhe ulje të çmimit, me qëllim “verifikimin e saktësisë dhe plotshmërinë e informacionit”, duke përfshirë kryerjen e verifikimeve doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe, verifikimin e saktësisë së vlerave të deklaruara pranë Institucioneve Shtetërore ligjzbatuese dhe autorizuese brenda vendit, përfshirë edhe ushtrimin e kontroleve kontabël pranë selive të operatorëve deklarues.

2.2. Rekomandimi: Gjithashtu, Sektori i Kontrollit pas Zhdoganimit të ndjekë verifikimin e rasteve të konstatuara që lidhen me llogaritjen e detyrimeve doganore për shpenzimet e transportit në shumën 4,396,563 lekë për deklarues të natyrës individë, me qëllim kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit doganor që do të lindë bazuar ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për disa operatorë tregtarë, për të cilët janë rekomanduar rivlerësime doganore për importe doganore, kryesisht për mallra të importuara nga Italia dhe Greqia, si vendetë Komunitetit Europian dhe vende që kanë Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore me Shqipërinë, nga Autoriteti Doganor Tiranë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese për importe të këtyre operatorëve tregtarë, të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për detyrime të rivlerësuara në shumën 7,795 mijë lekë për 3 operatorë tregtarë, bazuar në nenet 1 deri 23 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” dhe VKM nr. 331, datë 09.07.1993 “Miratimin e Marrëveshjes së

Asistencës Administrative ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë për Asistencën Doganore”, të Marrëveshjes me Bosnjë-Hercegovinën sipas VKM nr. 669, datë 11.06.2009, si dhe Anekseve nr. 29 deri 37, të Shtojcës 3 të Marrëveshjes me Kosovën. Gjithashtu, nuk është kryer garantimi për pjesën e detyrimit doganor të munguar, që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe pas kryerjes së verifikimeve doganore. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë për subjektet për të cilët nuk rezultojnë verifikime doganore të hetuara, por të cilët kanë kryer transaksione nga Italia dhe Greqia, si vende të Komunitetit Evropian, në zbatim të pikave 3, 4 dhe 5 të shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të MF, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore...”, i ndryshuar dhe bazuar në nenet 1 deri 23 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999dhe VKM nr. 331, datë 09.07.1993,të gjykojë dhe të rikërkojë ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në shumën 7,795 mijë lekë, për 3 operatorë tregtarë dhe kryerjen e procedurave doganore verifikuese, duke kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave **verifikimin e plotë dhe të garantuar** të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave dhe vlerave të transaktuara sipas deklarimeve pranë Autoriteteve Doganore Homologe, për praktika doganore të konstatuara, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” ku përcaktohet se “informacioni do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave” dhe përcaktimeve të VKM-së nr. 331, datë 09.07.1993 për “Miratimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë për Asistencën Doganore”,të Marrëveshjes me Bosnjë-Hercegovinën sipas VKM nr. 669, datë 11.06.2009 dhe Anekseve nr. 29 deri 37, të Shtojcës 3 të Marrëveshjes me Kosovën.(Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.2. Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë nëpërmjet Sektorit të Kontrollit pas Zhdoganimit,bazuar në nenet 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë veprime verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit dhe të rregjistrave të kontabilitetit financiar të kompanive të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, bazuar në përcaktimet e nenit 49, pika 1 dhe 2, ku përcaktohet se “Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore.....si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti, të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat, si dhe të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë”, për saktësime të informacionit të dhënë në deklaratat doganore që lidhen me problemet e trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike rezultoi se, nuk janë kryer në disa raste veprimet përkatëse për dorëzimin e dosjeve sipas regjimeve nga personeli përpunues doganor, shkaktuar kjo edhe nga transferimet e personelit doganor në detyra të reja funksionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Gjithashtu, Sektori i Regjimeve Ekonomike Doganore gjatë vitit ushtrimor 2017 ka funksionuar me një mungesë të theksuar personeli përpunues doganor, në nivelin mbi 50% të kapacitetit që duhej të ishte dhe

transferimi ose dorëzimi i dosjeve të regjimeve doganore ekonomike nuk rezultonte të kryhej sipas një akti përmbyllës dorëzues për inventarizimin e dosjeve. Gjatë administrimit të dosjeve të trajtuara në Raportin e Auditimit u konstatuan mangësi të dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e raporteve për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit, kontrolleve për verifikimin e kartave teknologjike, akteve të rakordimit 3 mujore dhe përfundimtare, akte modeli 1 dhe modeli 2, si dhe në disa raste lejet mjedisore për depozitimin e mbetjeve, etj., në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, bazuar në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat e Kodit Doganor”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 3, në faqet nr.56-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë të marrë masa për krijimin e një regjistri për regjimet që operojnë në këtë degë, si dhe të vijojë sa më shpejt me përgatitjen e dosjeve të plota, të inventarizuara, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, me qëllim plotësimin dhe arkivimin e dosjeve të regjimeve doganore ekonomike, duke ofruar siguri të mjaftueshme për sistemin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike u konstatua sesubjekti me NIPTJ...Gka shkelur kushtet dhe termat e lejuar në regjimet autorizuese, të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me nr.2768.1, datë 04.02.2015 dhe nr. 2364/1, datë 04.02.2016, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të neneve 107, 110-113, 136, 139, 142 dhe 256 deri 291, në Pjesën VIII “Shkeljet në fushën doganore” të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,i ndryshuar dhe shpjegimeve të VKM nr. 205, datë13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, Titulli 3, Kreu 1, Kreu 3,. Sesioni 1, si dhe përcaktimeve të Seksioni 2, nenet 274, 275, 278, 280, 284, 287, 289, 290, 296, 298, 299, 230, 301, 302 dhe 308 të këtijvendimi,me pasojë konstatimin llogaritjes së një detyrimi doganor në shumën totale 169,858,466 lekë,i përbërë nga detyrim doganor dhe gjobë doganore,duke konsumuar shkelje doganore në fushën e doganave, si pasojë e mosdorëzimit të mbylljes së regjimit dhe diferencave për sasi të konstatuara gjatë auditimit,trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 3, në faqet nr.56-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e Autoritetit Doganor Mbikëqyrës, të veprojë me veprime konkrete për ndjekjen e kontabilizimit të borxhit doganor që është llogaritur për subjektin me NIPT J...G,duke marrë në konsideratë shpjegimet e nenit 142, ku përcaktohet metodologjia e lindjes së një borxhi doganor në fushën e regjimeve doganore ekonomike mbi bazën e llogaritjes specifike, sipas periudhave të importit, duke llogaritur konkretisht produktet kompensuese kryesore, produktet kompensuese dytësore, humbjet dhe frot, koeficientin e shfrytëzimit nëpërmjet metodës së matjes sasiore dhe metodës së matjes mbi vlerën e mallit, që lidhen më këto dy autorizime specifike për konstatime të diferencave sasiore me pasojë evidentimin e detyrimeve doganore potenciale nëshumën 169,858,466 lekë, e përbërë nga detyrime doganore dhe gjobë doganore. Gjatë procedurave të vendimmarrjes dhe kontabilizimit të borxhit nga Dega Doganore Tiranë, të merret tërësisht në konsideratë përcaktimi i neneve 107, 110-113, 136, 139, 142 dhe 256 deri 291, përcaktuar në pjesën VIII “Shkeljet në fushën doganore” të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe faktiobjektiv që kjo

shoqëri tregtare punëson një numër të konsiderueshëm punonjësish, duke ndikuar dhe dhënë një impakt të drejtpërdrejtë në uljen e papunësisë në zonat që ushtron aktivitetin.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

a) Nga auditimi rezulton se, borxhi doganor në këtë degë në fund të vitit 2017 paraqitet në shumën 4,670,824 mijë lekë, si dhe konstatohet se gjatë kësaj periudhe kjo degë ka ekzekutuar vetëm një urdher ekzekutimi, në vlerë 151,106 lekë, si dhe janë kryer pagesa nga subjektet për likuidimin e borxhit në vlerën 181,852 mijë lekë, duke pasqyruar kështu një nivel tepër të ulët arkëtimi dhe zbatimi të masave për rikuperimin e këtij borxhi, i cili tregon një punë të pamjaftueshme të kësaj dege, të strukturave të specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe strukturave të tjera të shtetit, të ngarkuara me ligj për të mbështetur rikuperimin e borxhit doganor.

b) Nga auditimi konstatohet se, Dega e Doganës Tiranë nuk ka kryer kontabilizimin e vendimeve administrative, në vlerë **7,014,722 lekë, për 24 raste** në evidencën e borxhit për vitin 2017, të cilat mbajnë datën 30.12.2017, por ato janë mbartur për vitin pasardhës, duke mos pasqyruar saktë gjendjen e borxhit në 31.12.2017, të ndarë në detyrim doganor, gjobë doganore dhe kamatëvonesa, në kundërshtim me pikën 4, të udhëzimit nr. 6, datë 23. 07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor” dhe neneve 232-233 të Kodit Doganor.

c) Nga auditimi konstatohet se Sektori i Borxhit dhe i Financës në DDT nuk kanë kryer rakordimet përkatëse nëpërmjet këtyre dy sektorëve për konkludimin e një vlere të unifikuar mes tyre, duke rezultuar kështu në një diferencë në shumën **1,341 mijë lekë**, në raportimet përkatëse.

d) Nga auditimi i dosjeve të subjekteve debitore ndaj DDT konstatohen mangësi të konsiderohen mangësi të konsiderueshme në dokumentacionet shoqëruese si inventarizimet përkatëse, vendimet, urdhrat e ekzekutimit, përgjigjet e bankave të nivelit të dytë, zyrave të regjistrimit të pasurive, evidencat e procedurave gjyqësore, etj në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 të DPD.

e) Nga auditimi konstatohet se, pas përfundimit të procedurave për fshirjen e borxhit për subjektet e falura, Dega e Doganës Tiranë nuk ka vijuar me plotësimin e dosjeve përkatëse sipas subjekteve që rezultojnë ende të falura, duke bashkëlidhur në to pagesat e kryera, si dhe vendimet e faljes, apo në subjektet që nuk përfitojnë, vendimet gjyqësore të formës së prerë si dhe procedurat që kanë qenë në proces, gjatë vendimmarrjes për faljet respektive.

f) Nga auditimi konstatohet se për subjektet debitore ndaj DDT nuk janë ndërmarrë në të gjitha rastet në mënyrë të unifikuar hapat për vjeljen e borxhit, në zbatim të udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 të DPD, ku më konkretisht nuk janë kryer reduktimet për kryerjen e veprimeve doganore në sistemin Asycuda, nuk janë ekzekutuar urdhrat përkatës, nuk janë respektuar afatet kohore për titujt dhe urdhrat e ekzekutimit, veprim i cili deri këtu tregon për punën jo të mirë që ka bërë Sektori i Borxhit pranë DDT. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, në faqet nr. 91-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete, për të zgjidhur problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 4,670,824 mijë lekë, duke angazhuar të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi kërkesat e legjislacionit doganor nëpërmjet një programi të posaçëm, për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që rezultojnë në gjendje debitorë në vlera të mëdha.

6.2.Rekomandimi:Dega e Doganës Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrin masat për kryerjen e kontabilizimit dhe paraqitjen e qartë dhe të saktë të borxhit doganor për vitin 2017, duke pasqyruar në këtë vlerë edhe vendimet e datës 30.12.2017, në shumën **7,014,722 lekë, për 24 raste**

6.3.Rekomandimi:Sektori i Borxhit dhe Sektori i Financës në DDT, të marrin masat për kryerjen e rakordimeve përkatëse dhe dakortësimin e vlerës finale dhe të unifikuar për borxhin doganor të vitit 2017, duke evidentuar kështu diferencat në raportimet përkatëse mes këtyre dy sektorëve.

6.4.Rekomandimi:Dega e Doganës Tiranë, konkretisht Sektori i Borxhit në DDT të marrë masat për plotësimin e dosjeve përkatëse të subjekteve debitorë me informacionin e nevojshëm në zbatim të udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 të DPD, me dokumentacionin shoqërues për subjektet përfituese të ligjit të faljes, si dhe evidencës së borxhit për paraqitjen e informacionit të saktë, të rifreskuar në mënyrë periodike për raportimin e saktë të gjendjes aktuale si dhe masave të ndërmarra për rikuperimin e borxhit sipas subjekteve debitorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi mbi plotësimin e pasqyrave financiare, u konstatua se, nga struktura përgjegjëse për financën janë hartuar dhe dorëzuar në afat pasqyrat financiare të vitit 2017, por nuk ka hartuar dhe paraqitur inventarizimin e të drejtave dhe të detyrimeve, konkretisht: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në bilanc më 31.12.2017, për shumën 4,672,165,157 lekë, me një rritje prej 15,843,740 lekë krahasuar me periudhën e mëparshme, e pa analizuar me subjekte, veprime në kundërshtim me nenet 7, 9 dhe 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore...”, me ndryshime, KREU II, pikat 1 dhe 3, si dhe Udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”, pika 4.

Nga subjekti në momentin e hartimit të pasqyrave financiare jo vetëm nuk është kryer inventarizimi i kësaj llogarie, por nuk është bërë dhe rakordimi me degën e borxhit për evidentimin e saktë të borxhit doganor, pasi në kontabilitet pasqyrohen më shumë borxh doganor në *vlerën 1,340,702 lekë,ndërsa nga një verifikim i bërë në sistemin e kontabilitetit diferenca ndërmjet të dhënave të dy sektorëve është më e madhe. Megjithëse gjatë auditimit u kërkua inventarizimi dhe kuadrimi i llogarisë 468, nga dega doganore deri në fazën përfundimtare të auditimit nuk ka asnjë informacion për rezultatet e këtij procesi. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqet nr.118-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë,Sektori i Financës, të marrë masa për përfundimin e procesit të rakordimit të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, evidentimin dhe sistemimin e diferencave të mundshme, konform kërkesave të legjislacionit kontabël dhe atij doganor, me qëllim nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të kësaj llogarie.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi mbi plotësimin e pasqyrave financiare, u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” pasqyrohet me gjendje më 31.12.2017, në shumën 32,216,075 lekë, për të cilën nga struktura përgjegjëse për financën për DD Tiranë nuk evidentohet në mënyrë analitike, veprime në kundërshtim me nenet 7, 9 dhe 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë

28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore...”, me ndryshime, KREU II, pikat 1 dhe 3.

Në këtë llogari mbahen në evidencë në Degën e Thesarit Tiranë të ardhura në llogarinë 4662100 “Garancitë doganore”, në shumën 8,172,371 lekë, për 9 raste, të depozituara nga subjektet, të cilëve u është falur gjoba me garanci, ose ju ka humbur e drejta për tu rimbursuar. Me shkresën nr. 830prot., datë 21.01.2016 nga Dega Doganore Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Degës së Thesarit Tiranë, është kërkuar sistemimi i kësaj situatë financiare, për të bërë të mundur balancimin e llogarisë dhe pakësimin nga sistemi i thesarit i shumës së mësipërme. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk ka ndonjë reagim apo veprim deri në momentin e ushtrimit të këtij auditimi, edhe pse janë mbyllur dy periudha ushtrimore të aktivitetit të kësaj dege doganore. *(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqet nr.118-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Nga Dega Doganore Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degën e Thesarit Tiranë të rakordojë dhe sistemojë llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nën llogarinë 4662100 “Garancitë doganore”, shumën prej 8,172,371 lekë, për 9 raste, të depozituara nga subjektet për garanci doganore, të cilëve u është falur gjoba me garanci, ose ju ka humbur e drejta për tu rimbursuar, me qëllim pasqyrimin e drejtë të kësaj llogarie në pasqyrat financiare.

Brenda 28.02.2019

B 1.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Tiranë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit *në shumën 811,749,692lekë*, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor dhe qëllime të vlerës doganore që lidhen me vlerësimin doganor të disa mallrave, shpenzimet e transportit për qëllime të vlerës doganore, klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mosllogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, mospagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, duke krijuar të ardhura doganore të munguara në *shumën 184,956,910 lekë*, sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Aneksëve nr. 1-15, 15-24 dhe 26 bashkëlidhur këtij Raporti, për periudhën nga data 01.01.2017 deri në datën 31.12.2017, duke vepruar jo në përputhje me nenet 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të Ministrisë së Financave “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, shkresës nr. 779prot., datë 16.01.2013 të DPD “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shitesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” dhe ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore

në shumën 184,956,910 lekë, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe që lidhen me rillogaritje të detyrimeve doganore në import, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, shkresës nr. 779prot., të DPD, datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE” dhe ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”.

Deri më 31.05.2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor, që lidhen me vlerësimin doganor artikujve që janë deklaruar në kapitullin *02*, ku janë evidentuar mospërputhshmëri ligjore me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme”, keqinterpretim i shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 1945prot., datë 25.01.2016 “Mbi zhdoganimin e artikujve që deklarohen në kapitullin *02* me origjinë nga EU”, dalë sipas përcaktimeve të neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, **në shumën 250,274,956 lekë**, sipas aneksit 27, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr. 14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative, për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore **në shumën 250,274,956 lekë**, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017, që lidhen me rillogaritje të detyrimeve doganore në import për deklarime të mallrave të kapitullit *02* të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave. Problematika për kontabilizimin dhe vjeljen e borxhit doganor e trajtuar ngarillogaritja e detyrimeve doganore në procedura importi për deklarime të mallrave të kapitullit II të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, do të rekomandohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit deri në momentin që, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Publik më i lartë do të shprehen zyrtarisht për vlefshmërinë ligjore apo shfuqizimin e shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016, të cilat bien ndesh me përcaktimet dhe trajtimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme”.

Deri më 31.05.2019

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se, nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta deklarimet doganore ku duhej të paguhej taksa doganore kombëtare TAM, si dhe nuk është zbatuar me korrektësi përcaktimi ligjor i shprehur në Udhëzimin nr. 2, datë 17.01.2014 të Ministrisë të Financave, dalë në mbështetje të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, i cili në pikën 2.8.5 përcakton se: “Në rastet e importimit të produkteve gjysmë të gatshme që përkojnë sipas kodeve të NK-së të përcaktuara, të cilat janë qartësisht të destinuara për prodhimin e ambalazheve të plastikës apo qelqit, të përcaktuara në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, TAM paguhet në momentin e

*importimit, pavarësisht nëse importuesi është prodhues vendas dhe i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues, apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare”, duke krijuar të ardhura doganore/tatimore të munguara në **shumën 296,719,000 lekë**, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017, sipas aneksit 25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në analizimin e konstatimeve sa më sipër,duke bashkëpunuar thellësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim pagimin e detyrimeve doganore ose tatimore të Taksës Kombëtare TAM, në procedura importi ose në procedura shitje malli brenda vendit me fatura tatimore shitje, **në shumën 296,719,000 lekë**, për periudhën nga data 01.01.2017 deri në datën 31.12.2017.

Deri më 31.05.2019

4. Gjetje nga auditimi. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës “*Energji Elektrike*”, të deklaruar në kapitullin *2716*, u konstatua se dokumentacioni tregtar bashkëngjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush edhe kushtet për trajtim vlerësimi sipas metodës së transaksionit sipas nenit 34 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar dhe neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”, si dhe shpjegimet e nenit 35 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, nenit 54, Titulli VI “*Vlera Doganore*” pika c, e VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”, i ndryshuar, nenit 64, pika 1,b e VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”, i ndryshuar, Pikës 4 e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “*Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore*” që lidhet me “*Metodën dytësore për vlerësimin doganor*”, duke mos kryer rivlerësimin doganor të artikullit “*energji elektrike*” për subjektin Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në shumën **34,473,600 lekë**, sipas Aneksit nr. 14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlerësimit Doganor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të rillogaritura, duke kërkuar informacion ligjor pranë Autoriteteve Shtetërore që rregullojnë dhe normojnë aktivitetin specifik të rregullave ligjore dhe kontraktuale të importit të energjisë elektrike, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore **në shumën 34,473,600 lekë**, për periudhën objekt auditimi dhe që lidhen me rillogaritje pagesash për detyrime doganore në import për subjektin Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 35 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar, nenit 54, Titulli VI “*Vlera Doganore*” pika c dhe nenit 64, pika 1,b e VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”, i ndryshuar, si dhe Pikës 4 të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “*Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore*”.

Deri më 31.05.2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore të subjekteve që operojnë sipas ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, u konstatuan veprime të kryera jo në përputhje me germën (c) të pikës 3, të nenit 20 dhe nenit 85 të

këtij ligji dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 71/2014, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 12, pika (2), shkronja (a), diferenca të konstatuara gjatë rakordimit të bilancit material të disa operatorëve me status depozitues të miratuar në raport me mallra të hyra në prodhim dhe sasive të nxjerra si produkt përfundimtar, mospagesë akcize për mallra që duhet të paguajnë akcizë sipas ligjit për akcizat, për deklarime në kodet tariforë *3811*dhe *3403*, me rillogaritje detyrimesh doganore, në shumën totale **4,132,453 lekë**, nga të cilat 1,695,221 lekë në formën e detyrimit doganor dhe 2,437,232 lekë gjobë doganore, sipas Aneksit nr. 29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqet nr.110-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë nëpërmjet Sektorit të Akcizës të kërkojë arkëtimin e detyrimit doganor dhe sanksioneve doganore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke kryer verifikime dhe kontrole specifike pranë regjistrave të kontabilitetit të operatorëve ekonomikë dhe ambjenteve të deklaruara në autorizimet e marra me status depozitues të miratuar, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor konstatuar në shumën totale **4,132,453 lekë**, nga të cilat 1,695,221 lekë në formën e detyrimit doganor dhe 2,437,232 lekë gjobë doganore për 14 raste/subjekte.

Deri më 31.05.2019

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2017, të marra për shkeljet në fushën doganore, rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e neneve 256.1; 256.2, 261.1 dhe 261.2 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në shumën totale **40,392,763 lekë, për katër subjekte**.(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqet nr. 105-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendimet administrative në shumën totale **40,392,763 lekë, për katër subjekte**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen e vendimeve administrative dhe arkëtimin e detyrimeve doganore e gjobave doganorenga 4 operatorët tregtarë.

Deri më 31.01.2019

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2017, të marra për shkeljet në fushën doganore, rezultoi se vendimi administrativ **nr. 183, datë 26.04.2017 për rimbursimin në shumën 800,010 lekë të subjektit “A...” Shpkështëmarrë** në shkelje të kërkesave të neneve 33-37 të Kodit Doganor, si dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë së Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit”.(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqet nr.105-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore të vendimit administrativ nr. 183, datë 26.04.2017, në shumën**800,010 lekë**, duke ndjekur të gjitha

procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen e vendimit administrativ dhe arkëtimin e detyrimeve doganore.

Deri më 31.01.2019

B.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E ARDHURAVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike u konstatua sesubjekti me NIPT J...Gka shkelur kushtet dhe termat e lejuar në regjimet autorizuese, të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me nr.2768.1, datë 04.02.2015 dhe nr. 2364/1, datë 04.02.2016, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të neneve 107, 110-113, 136, 139, 142 dhe 256 deri 291, në Pjesën VIII “Shkeljet në fushën doganore” të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe shpjegimeve të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, Titulli 3, Kreu 1, Kreu 3., Sesioni 1, si dhe përcaktimeve të Seksioni 2, nenet 274, 275, 278, 280, 284, 287, 289, 290, 296, 298, 299, 230, 301, 302 dhe 308 të këtij vendimi, me pasojë konstatimin llogaritjes së një detyrimi doganor të nxjerrë nga të dhënat statistikore të nxjerra nga sistemi elektronik Asycuda Word në shumën totale 169,858,466 lekë, i përbërë nga detyrim doganor dhe gjobë doganore duke konsumuar shkelje doganore në fushën e doganave, si pasojë e mosdorëzimit të dokumentit të mbylljes së regjimit dhe diferencave të krijuara në kontabilitetin statistikor sipas të dhënave të sistemit për sasi të konstatuara në mungesë gjatë procedurave doganore import eksport që lidhen me këto dy autorizime, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në Pikën 3, në faqet nr.56-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e Autoritetit Doganor Mbikëqyrës, të veprojë me veprime konkrete për dhënien e destinacionit të mallrave të hyra sipas autorizimeve të tipit RPA dhe RLP të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore sipas deklarimeve statistikore të kryera në procedura doganore IMP 5 dhe sanksioneve respektive për për ndjekjen e kontabilizimit të borxhit doganor që është llogaritur për subjektin me NIPT J...G, duke marrë në konsideratë shpjegimet e nenit 142, ku përcaktohet metodologjia e lindjes së një borxhi doganor në fushën e regjimeve doganore ekonomike. Dega Doganore Tiranë, në cilësinë e Autoritetit Doganor Mbikëqyrës të veprojëme programe kontrolli konkrete mbi bazën e llogaritjes specifike, sipas periudhave të importit, duke llogaritur konkretisht produktet kompensuese kryesore, produktet kompensuese dytësore, humbjet dhe firot, koeficientin e shfrytëzimit nëpërmjet metodës së matjes sasiore dhe metodës së matjes mbi vlerën e mallit, që lidhen me këto dy autorizime specifike për konstatime të diferencave sasiore me pasojë evidentimin e detyrimeve doganore të llogaritura si pasojë e mosdorëzimit të dokumentit të mbylljes së regjimit dhe diferencave të krijuara në kontabilitetin statistikor sipas të dhënave të sistemit elektronik Asycud Word për sasi të konstatuara në mungesë gjatë procedurave doganore import eksport me një detyrim doganor të nxjerrë sipas të dhënave të nxjerra nga sistemi Asycuda Word në shumën 169,858,466 lekë. Në përfundim gjatë procedurave të vendimarrjes dhe kontabilizimit të borxhit nga Dega Doganore Tiranë, të merret tërësisht në konsideratë përcaktimi i neneve 107, 110-113, 136, 139, 142 dhe 256 deri 291, përcaktuar në pjesën VIII “Shkeljet në fushën doganore” të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave doganore, gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike rezultuan veprime që kanë sjellë pasojë në mosrespektim të afateve dhe sasive

autorizuese, që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike që janë autorizuar të operojnë në fushën e regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv dhe pasiv, si dhe regjimeve doganore ekonomike të lejimit të përkohshëm, për periudhën objekt auditimi, në shumën totale 14,433,450 lekë, nga të cilat shuma prej 12,315,746 lekë, konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA dhe shuma prej 2,117,704 lekë, e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP, sipas Aneksit nr. 28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me kërkesat eligjtit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat e Kodit Doganor”, Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” dhe ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 3, faqet nr.56-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi:Dega Doganore Tiranë të ndjekë dhënien e destinacionit të mallrave të hyra sipas autorizimeve të tipit RPA dhe RLP të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore sipas deklarimeve statistikore të kryera në procedura doganore IMP 5 dhe sanksioneve respektive në shumën totale 14,433,450lekë. Shuma prej 12,315,746 lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA dhe shuma prej 2,117,704 lekë, e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP për shkelje doganore të ndryshme të kryera nga operatorët tregtarë, në kundërshtim dhe tejkalim të afateve administrative autorizuese. Dega Doganore Tiranë të ndjekë të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Degës Doganore Tiranë, që në vlerësimin dhe gjykimin përfundimtar të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të konkludojë me nisjen e procedurave sipas pikës 1 gërma “b”, “c” dhe “ç” të nenit 57 dhe 58 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, si më poshtë:

I.a “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” deri në “largim nga shërbimi civil”, sipas nenit 58, germa “c-c”, për nëpunësit civil, si më poshtë:

- 1. Për znj. G. G.,** me detyrë doganiere e Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier vlerësues pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;
- 2. Për z. E.S.,** me detyrë doganier i Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier vlerësues pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

3. Për znj. K. Xh., me detyrë doganiere e Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier vlerësues pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

I.b “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil” sipas nenit 58, germa “b-c”, për nëpunësin civil, si më poshtë:

1. Për znj. L. G., me detyrë doganiere e Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier vlerësuese pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2prot., të DPD, datë 12.11.2012, dalë në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...”, nxjerrë për këtë qëllim, që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe që lidhen me rillojaritje të detyrimeve doganore në import, për klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat e Nomenklaturës së Mallrave në RSH, mosllogaritje të detyrimeve doganore të taksës kombëtare të amballazhit plastik, mosllogaritje të shpenzimeve të transportit për qëllime të vlerësimit doganor të mallrave, mospagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe SHTOJCES 5 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është vepruar në përputhje me nenet 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e shkresës nr. 779prot., të DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, për veprime jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare TAM për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014, pika 2.8.5 dheligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keqklasifikim artikujsh, me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 14-55).

II. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” deri në “largim nga shërbimi civil”, sipas nenit 58, germa “c-c”, për nëpunësin civil, si më poshtë:

1. Për z. F.K., me detyrë specialist jurist pranë Degës Doganore Tiranë:

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2prot, të DPD datë 12.11.2012, dalë në

zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, në lidhje me hartimin dhe shqyrtimin paraprak të vendimeve administrative, konkretisht gjatë hartimit dhe përgatitjes së procedurës vendimmarrëse për subjektin meNIPT J...G, në lidhje me konstatimet e patrajuara nëpërmbytjen e Vendimit nr. 266, datë 18.04.2018 gjatë procedurave hartuese të këtij vendimi, për konstatimet e trajtuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë Raport Përfundimtar Auditimi që lidhet me mosevidentimin e sasisë së mallit të evidentuar si mungesë gjëndje malli , në sasi dhe vlerë.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 56 deri në faqe 91).

III. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” deri në “pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, sipas nenit 58, germa “b-c”, për nëpunësin civil, si më poshtë:

1. Për znj. V. H., me detyrë doganiere e Sektorit të PërrjashtimevedheRegjimeve pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganiere pranë Degës Doganore Rinas:

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2prot., të DPD, datë 12.11.2012, dalë në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, konkretisht në lidhje me mbikëqyrjen e regjimit doganor ekonomik të tipit RPA, që lidhet me subjektin me NIPT J...G, në lidhje me rezultatet dhe konstatimet e trajtuara në procesverbalit nr. 21, datë 03.11.2017 të DPD-se. znj. V. H. ka qenë në cilësinë e personit mbikëqyrës të këtij rregjimi doganor ekonomik ku kanë rezultuar veprime me pasojëshkelje doganore të ndryshme të kryera në kundërshtim dhe tejkalim të afateve administrative autorizuese, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, në lidhje me Autorizimin nr. 2768/1, datë 04.02.2015, lëshuar dhe lejuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 56 deri në faqe 91).

IV.a “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” deri në “pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” sipas nenit 58, germa “b-c”, për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për z. R.Sh., me detyrë doganier i Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Fizik pranë Degës Doganore Tiranë;

2. Për z. A.M., me detyrë doganier i Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier skanimit në Sektorin e Përpunimit dhe Kontrollit në sheshin e trageteve pranë Degës Doganore Durrës.

3. Për znj. A. H., me detyrë doganiere e Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier vlerësuese pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

VI. b “Nga vërejtje” deri “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” sipas nenit 58, germa “a-b”, për nëpunësin civil si më poshtë:

1. Për z. A.V., me detyrë doganier i Sektorit të Klasifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit Dokumentar dhe Fizik pranë Degës Doganore Tiranë, aktualisht me detyrë doganier vlerësuese pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2prot., të DPD, datë 12.11.2012, dalë në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh, me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kryesisht që lidhen me deklarime në kapitullin *39* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH.

-për veprime jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e taksës kombëtare të amballazhit për artikujt që duhet të paguajnë këtë taksë kombëtare, përcaktimet e shpjegimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 17/01/2014, pika 2.8.5.

-për veprime që kanë sjellë pasojë mospagesa të detyrimeve doganore të mallrave që duhet të paguajnë akcizë, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50 dhe SHTOJCËS 5 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për deklarime në kërçet tariforë *3811* dhe *3403*.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 14-55).

D. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE.

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

E. TË TJERA.

1. Në shkresën nr. 1222, datë 15.11.2018, dërguar drejt Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga Shoqëria “C... Sh.” Shpk, parashtrohen shqetësimet e kësaj shoqërie në lidhje me rivlerësime doganore për artikujt “sheqer” dhe “pipeta plastike” të trajtuara në Projektraportin e Auditimit, dërguar Degës Doganore Tiranë me shkresën përcjellëse nr. 660/6prot., datë 03.10.2018 dhe Raportin Përfundimtar

të Auditimit, dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 281/13prot, datë 05.10.2018 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

a. Në lidhje me ankesën e bërë nga kjo shoqëri për artikullin “*sheqer*” konstatohet se nga procesi auditues i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, rezultatet e të cilit janë përcjellë me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës nr. 281/13prot, datë 05.10.2018, sipas Vendimit nr. 153, datë 29.09.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë këtij institucioni, së bashku me rekomandimet dhe masat për përmirësimin e gjendjes dhe situatës, rezulton se për këtë shoqëri tregtare është lënë rekomandim në lidhje rivlerësimin e artikullit “*sheqer*”, të importuar nga kjo shoqëri tregtare. Rekomandimi i lënë lidhet me problematikën e rivlerësimit të këtij artikulli mbi bazën e të dhënave të administruara nga sistemi elektronik dhe shkresor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, bazuar në të dhënat e disponueshme, dalë në mbështetje të Kodit Doganor.

Gjatë procesit auditues është konstatuar se, Autoriteti Doganor Tiranë me shkresën nr. 11045/1prot., datë 12.01.2018, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 845prot, datë 12.01.2018, ka marrë në shqyrtim problematikën e rivlerësimit doganor sipas rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke u shprehur qartësisht me gjykime dhe vlerësime përfundimtare për artikullin “*sheqer*” me përdorim dhe destinacion përfundimtar industrial, si lëndë e parë në prodhimin e produkteve të njohura të kompanisë C..., të klasifikuar në kreun *1701* të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në Republikën e Shqipërisë. Në këtë përgjigje të Autoritetit Doganor Tiranë është konkluduar se: “*vlerësimi i produktit sheqer të kryhet duke pranuar vlerën e transaksionit si vlerë doganore, pasi nga shqyrtimi i indikatorëve të nevojshëm për vlerësim doganor rezulton se faturat e mallit përmbajnë informacion të plotë për çmimet, çmimi është dukshëm më i ulët se çmimi i dosjes së të dhënave të disponueshme, vlerat e deklaruara janë më të larta se vlerat e deklaruara nga importues të mallrave identike, produkti i importuar nuk është për qëllime tregtimi, por për prodhimin e pijeve*”. Në këtë shkresë sqarohet dhe argumentohet se, nga Autoriteti Doganor Tiranë është kërkuar dokumentacion shtesë nga operatori tregtar “C...shpk” dhe në përfundim, nga ky operator është paraqitur kontrata e nënshkruar me kompaninë eksportuese për sasinë vjetore të importit dhe transfertat bankare për pagesat kryera.

Gjithashtu, në ankesën e paraqitur nga shoqëria tregtare C..., pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit rezulton se, kjo shoqëri importon sasi sheqeri me aktivitet për qëllime prodhimi dhe jo rishitje dhe se kontraktimi dhe përzgjedhja e furnitorëve që lëvrojnë këto artikuj bëhet globalisht në gjithë botën nga kompania mëmë “*The C.C.*”, duke përfituar një çmim global dhe të favorshëm dhe duke pretenduar njëkohësisht edhe vërtetësinë e transaksioneve të kryera, duke vënë në dispozicion gjithë dokumentacionin e duhur pranë Autoriteteve Doganore Shqiptare. Në ankesën e paraqitur nga shoqëria C... detajohen të argumentuara informacione shtesë, në lidhje me problematikën dhe historikun e deklarimeve doganore që ka vijuar që prej vitit 2015 për artikullin “*sheqer*”, deri në momentin e depozitimit të kërkesës pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, që lidhen me destinacionin dhe qëllimin e importimit të këtij artikulli për qëllime prodhimi dhe jo rishitje e për të cilat ky Institucion vihet në dijeni.

b. Në ankesën e paraqitur nga shoqëria C... trajtohen edhe problematika që lidhen me rekomandimet e lëna në Projektraportin e Auditimit, dërguar Degës Doganore Tiranë me shkresën përcjellëse nr. 660/6prot., datë 03.10.2018, për rivlerësime të disa lëndëve të para për prodhimin e shisheve plastike “*pipeta plastike*” (*preforms pet*), duke pretenduar se ky artikull është lëndë e parë ndihmëse në procesin e prodhimit të pijeve freskuese. Gjatë auditimit u konstatuan rivlerësime doganore për shumë subjekte importues në tërësi të artikullit “*Lëndë të para plastike pipeta plastike*”, për të cilën Kontrolli i Lartë i Shtetit është shprehur në pjesën observuese me një gjykim përfundimtar për të

gjithë operatorët tregtarë,ku janë trajtuar me rekomandime për rivlerësime doganore dhe rillogaritje të ardhurash doganore dhe po kështu edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Në këto kushte, nisur sa kemi cilësuar më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, bazuar në nenet 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, në bashkëpunim me Autoritetin Doganor Tiranë, në cilësinë e organit zbatues dhe vendimmarrës, për përdorimin efektiv të fakteve dhe provave të paraqitura nga subjekti ankues C... në shkresën nr. 1222prot., datë 15.11.2018, përfshirë verifikimin e procedurave prodhuese dhe atyre të shitjes, të dhënat e kontabilitetit të aktivitetit tregtar dhe financiar të këtij operatori, investigimin e destinacionit të artikullit “*sheqer*”, ngritur si pretendim nga subjekti ankues duke marrë në konsideratë destinacionin përfundimtar të këtij artikulli si pjesë integrale e procesit të prodhimit të pijeve, trajtuar edhe në shkresën nr. 1045/1prot., të DDTiranë, datë 12.01.2018, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 845prot., datë 12.01.2018. Gjithashtu, të merren në konsideratë metodat dhe radha e procesit ligjor të vlerësimit doganor dhe përputhshmëria me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”, i shfuqizuar me Udhëzimin nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*” dhe përcaktimeve të neneve 34 deri 36 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar dhe neneve 65 deri 70 të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të vlerësojë me profesionalizëm çdo rekomandim të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të veprojë në përputhje të plotë me ligjin dhe praktikën ndërkombëtare, sidomos kur flitet për artikuj dhe praktika të njohura për të dhe të shmangë përdorimin e njëanshëm të rekomandimeve të KLSH-së, dukë dëmtuar punën e investitorëve të rëndësishëm në të ardhmen. Mbetet në diskrecion të plotë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që të vlerësojë impaktin e çdo gjetje të auditimit, duke vlerësuar risqet, por edhe duke marra masa vetëm në rast se gjykon se kanë prekur të ardhurat e buxhetit apo konkurrencën në tregjet respektive, kjo duke e kombinuar në rastin konkret me procedura verifikimi të proceseve prodhuese dhe atyre të shitjes, të dhënat e kontabilitetit të aktivitetit tregtar dhe financiar të këtij operatori, investigimin e destinacionit të artikullit “*sheqer*”, ngritur si pretendim nga subjekti ankues.

1.2 Rekomandimi:Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë për problematikën e cituar sa më lart, të kryejë dhe ezaurojë të drejtën e procedurave doganore verifikuese pranë selive të kompanive lehtëuese të mallit për artikullin “*sheqer*” pranë Autoriteteve Doganore Homologe respektive, bazuar në Marrëveshjet Reciproke të Asistencës Administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Vendeve ku janë të atashuara selitë lehtëuese të këtij artikulli, me të cilët administrata doganore shqiptare ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore për deklarime doganore të trajtuara në rekomandimin e lënë më parë për artikullin “*sheqer*”, si dhe të tjera deklarime në vijim që do të gjykohen dhe përzgjidhen nga Administrata Doganore Shqiptare, ngritur si pretendim nga subjekti ankues.

1.3 Rekomandimi: Në parim, nga shqyrtimi i observacionit të paraqitur nga kjo shoqëri me shkresën nr. 1222prot., datë 15.11.2018, pranë Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për problematikën e artikullit “*sheqer*”, në referim të fakteve dhe provave të paraqitura në lidhje me destinacionin e këtij artikulli, për qëllime prodhimi dhe jo rishitje në tregun vendas, gjykohet se faktet qëndrojnë dhe duhet të verifikohen në vijimësi nga ana e Administratës Doganore Shqiptare.

Në përfundim të fakteve dhe provave të trajtuar sa më sipër, si dhe në ankesën e Shoqërisë C....Shpk, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit ju bëjmë me dije se, është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë, si të vetmet **Autoritete Publike dhe të Kompetencës** që duhet të informojnë sa më parë shoqërinë C... mbi veprimet ligjore që do të ndërmerren në vijim **për zgjidhjen e problematikës së cituar** në shkresë, për rivlerësimin artikullit “*sheqer*”, trajtuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit, miratuar me Vendimin nr. 153, datë 29.09.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 281/13prot, datë 05.10.2018. Veprimtaria dhe përfshirja e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në këtë problematikë buron nga përmbajtja e ligjit organik mbi bazën e të cilit funksionon ky Institucion i pavarur dhe ka karakter rekomandues për Autoritetet Publike dhe të Kompetencës, parashikuar nga nenet 10, 15 dhe 16 i ligjit organik nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”. KLSH, do të pranojë vendimmarrjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Doganor Tiranë për këtë problematikë, si *AutoritetePublikedhetëKompetencës*.

2.Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në lidhje me mospërputhshmërinë ligjore të shkresave nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të cilat bien në kundërshtim me shpjegimet dhe përcaktimet e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme.*”, si dhe neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, trajtuar më parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë rekomandimeve të lëna në vijimësi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore Tiranë, Durrës dhe Fier, nuk rezulton një qëndrim përfundimtar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ose nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Publik më i lartë, në lidhje me rekomandimet KLSH-së, për vlefshmërinë apo shfuqizimin e këtyre shkresave. Deri në këtë moment nuk rezulton asnjë iniciativë ligjore nga këto dy **Autoritete Publike dhe të Kompetencës**, në lidhje me shprehjen e vullnetit të vlefshmërisë apo shfuqizimit të shkresave të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm të Doganave.

Nga ana e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në përgjigjen e dhënë për shoqatën “A...”, me shkresën nr. 43/2prot., datë 27.02.2018, me lëndë “*Kthim Përgjigje*” në dy letrat nr. 84 dhe nr. 85, datë 08.01.2018”, adresuar njëkohësisht për Kryeministrin e RSH, Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave sqarohet pavlefshmëria dhe mospërputhshmëria me Kodin Doganor dhe kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme.*” e këtyre dy shkresave të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Nga auditimi u konstatua se, janë trajtuar detyrime doganore të rilloaritura për subjektet tregtarë që operojnë në shoqatën “A..”, të cilët importojnë mallra të deklaruar në kapitullin II të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në Republikën e Shqipërisë, sipas përshkrimit “*Mishi dhe të brendshmet e tij*”. Konstatohet se, nga personeli përpunues doganor nuk janë llogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor, që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në kapitullin II të Nomenklaturës në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, janë evidentuar mospërputhshmëri ligjore me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme.*”, si pasojë e zbatimit në praktikë të shkresës me nr. 1945prot., datë 25.01.2016 “*Mbi zhdoganimin e artikujve që deklarohen në kapitullin *02* me origjine EU dhe shkresës nr. 2344prot., datë 28.01.2016, me një efekt në të ardhurat doganore në*

trajtën e detyrimit doganor të shprehur qartësisht dhe të trajtuar në faqen nr.14 deri 55 në RaportinPërfundimtar të Auditimi. Gjithashtu, gjatë procesit auditues u administruan verifikime doganore të ardhura nga Autoritetet Doganore Homologe me të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi, të cilat rezultojnë të rregullta, por që i përkasin vitit deklarues 2016, periudhë jashtë juridiksionit të Programit të Auditimit me nr. 660/1prot., datë 13.06.2018, i cili përkon me veprimtarinë e audituar nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2017. Gjatë auditimit konstatohet se, nga Autoriteti Doganor Tiranë janë dërguar 13 shkresa për verifikim doganor pranë Drejtorisë së Hetimit dhe Departamentit Operativ-Hetimor në DPD, që përmbajnë shumë praktika doganore për verifikim të cilat kanë rezultuar të konfirmuara dhe të rregullta. Gjithashtu, rezultojnë të dërguara rreth 54 praktika doganore për 14 operatorë importues të mishit që operojnë në shoqatën “A...” nga Autoriteti Doganor Tiranë për verifikim doganor pranë Autoriteteve Doganore Homologe, të evidentuara me rivlerësime të detyrimeve doganore në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe që i përkasin vitit 2017, si periudhë nën juridiksion auditimi, trajtuar më hollësisht në këtë material. (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqet nr.14-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi:Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose Ministri i Financave dhe Ekonomisë si Autoriteti Publik më i lartë, të ndërpriten të gjitha procedurat vlerësuese doganore që marrin në konsideratë ligjore shkresat e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016 dhe që lidhen me vlerësimin doganor të artikujve që deklarohen në kapitullin II, të trajtuar edhe më parë nga ana e KLSH-së, në mospërputhje me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”, i ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose Ministri i Financave dhe Ekonomisë si Autoriteti Publik më i lartë, të shprehet në mënyrë eksplicite dhe të menjëhershme në lidhje me vlefshmërinë ose shfuqizimin e shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016, të cilat bien ndesh me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”, i ndryshuar.

Nëse, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Publik më i lartë ose Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, do të shprehet me një qëndrim vlefshmërie ose shfuqizimi në lidhje me shkresat nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, mbetet në gjykimin dhe kompetencat e tyre ekskluzive, rikërkimi i detyrimeve doganore të rekomanduara nga KLSH, bazuar në përcaktimet dhe hapat ligjorë në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi, për detyrimet doganore të rillogaritura në ngarkim të subjekteve tregtare, anëtarë të shoqatës “A...”, të cilët kanë importuar dhe importojnë mallra të deklaruar në kapitullin II me përshkrimin “*Mishi dhe të brendshmet e tij*” të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në Republikën e Shqipërisë.

2.2 Rekomandimi:Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë në vijim të procedurave të mëtejshme ligjore, të vlerësojë dhe gjykojë për problematikën e cituar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, duke ndjekur dhe respektuar metodat dhe radhën e procesit ligjor të vlerësimit doganor dhe përputhshmërinë me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të DPD “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”, i shfuqizuar me Udhëzimin nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*” dhe përcaktimeve të neneve 34 deri 36 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i shfuqizuar dhe neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së*

Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë për problematikën e cituar sa më lart të kryejë dhe ezaurojë të drejtën e procedurave doganore verifikuese pranë selive të kompanive lëvruese të mallit për artikuj të deklaruar në kapitullin II të Nomenklaturës së Mallrave në RSH, pranë Autoriteteve Doganore Homologe respektive bazuar në Marrëveshjet Reciproke të Asistencës Administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Vendeve ku janë të atashuara selitë lëvruese të këtij artikulli me të cilët administrata doganore shqiptare ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistencë Doganore, për deklarime doganore të periudhës nën juridiksion auditimi nga Administrata Doganore Shqiptare, duke garantuar njëkohësisht edhe borxhin doganor që mund të lindë.

2.3 Rekomandimi Në përfundim të fakteve, në lidhje me problematikën e ngritur nga operatorët tregtarë të Shoqatës “A...”, të cilët importojnë mallra të deklaruar në kapitullin II të Nomenklaturës në Republikën e Shqipërisë sipas përshkrimit “*Mishi dhe të brendshmet e tij*”, drejtuar Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ju bëjmë me dije se, është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Tiranë, si të vetmet **Autoritete Publike dhe të Kompetencës** që duhet të ndërmarrin hapat e duhur ligjorë për zgjidhjen e problematikës trajtuar në shkresën e KLSH-së, nr. 43/2prot., datë 27.02.2018, me lëndë “*Kthim Përgjigje mbi pretendimet e ngritura nga shoqata “A...” në dy letrat nr. 84 dhe nr. 85, datë 08.01.2018*”, si dhe me konstatimet e trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi me një efekt në të ardhurat doganore në trajtën e detyrimit doganor të rillogaritur, të shprehur qartësisht dhe të trajtuar në faqen nr.14 deri 55 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi. Veprimtaria dhe përfshirja e Kontrollit të Lartë të Shtetit në këtë problematikë buron nga përmbajtja e ligjit organik mbi bazën e të cilit funksionon ky Institucion i pavarur dhe ka karakter rekomandues për Autoritetet Publike dhe të Kompetencës, parashikuar nga nenet 10, 15 dhe 16 të ligjit organik nr. 154/2014, datë 27.11.2017 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Shënim:

1. Në përfundim, për rezultatet e këtij verifikimi Kontrolli i Lartë i Shtetit do të informojë për sa më sipër palët e tjera të interesit, të përfshira në këtë problematikë me apo pa dashje, e cila vijon prej më se një viti.

2. Projektvendimi është protokolluar më datë 20.12.2018 dhe deri më datë 27.12.2018 Vendimi, numri i të cilit nuk ndryshon, është diskutuar me drejtuesit e KLSH-së për pikën E “TË TJERA”, që ka të bëjë me ankimimet e dy subjekteve, trajtuar sa më sipër.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R